



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:128631

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05744418

**Ac.nr.991/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Salluka dhe Hunaida Pasuli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sadik (Bajram) Kurtaj, nga fshati Vitomericë, Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson i autorizuari L.... L....., avokat në Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve „Eurosig”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuar E.... A....., nga Prishtina, për shkak të kompensimit të demit jo material, vlera e kontestit: 4,904.40 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1004/20, të datës 10.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1004/20 i datës 10.11.2020, **VËRTETOHET**.

**II. Pika II** e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1004/20 i datës 10.11.2020, mbetet e pashqyrtuar.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1004/20 të datës 11.08.2021, në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar pjesësisht kërkesëpadinë e paditësit S.... (B.....) K....., nga fshati V....., Komuna e Pejës, ashtu që e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve „Eurosig”, me seli në Prishtinë, që në emër të demit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 20.07.2015, në bazë të auto përgjegjësisë, paditësit t’ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë, dhe atë në emër të gjitha llojet e intezitetit të dhimbjeve fizike, shumën prej 2.000,00 euro, në emër të gjitha llojet e intezitetit të frikës, shumën prej 1.500,00 euro, në emër të shpenzimeve për mjekim, shumën prej 154,40 euro. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit S..... (B.....) K....., nga

fshati V....., Komuna e Pejës, përtej shumës së gjykuar, për kompensimin e dëmit jo material dhe material, dhe atë shumat e specifikuar si në vijim: për zhdëmtimin në emër të shpenzimeve të dhimbjeve fizike shumën prej 1.150,00 euro për zhdëmtimin në emër të frikës shumën prej 1.100,00 euro sit ë pa bazuar. Në pikën e tretë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve „Eurosig”, me seli në Prishtinë, që shumat e gjykuara si në pjesën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 3.654,40 euro, me kamatë prej 8 % në vit, nga data 10.11.2020, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 689,00 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar ashtu që ti gjykojë shumat dukshëm më të ulta.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195, paragrafi, 1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

#### **Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi S..... K..... nga fshati V....., Komuna e Pejës, të cilët me autorizim e përfaqëson I.... I....., avokat në Pejë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë për kompensim dëmi për shkak se me datë 20.07.2015, në rrugën Pejë-Prishtinë, dhe atë pikërisht në fshatin Gllarevë, Komuna e Klinës, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në mes të automjetit të markës “Audi 4L”, me tabela të regjistrimit 03-570-EB, të cilin e ka drejtuar E.... (S.....) J....., nga Prishtina, pronë e kompanisë „Birra e Pejës”, dhe automjetit të markës “BMË 335”, me tabela të regjistrimit 03-127-CR, të cilin e ka drejtuar S.... (B.....)K....., nga fshati V....., Komuna e Pejës, pronë e Z..... N....., nga fshati Shtypeq i Madh, Komuna e Pejës, dhe përderisa të dy drejtuesit të automjeteve ishin duke qarkulluar, drejtuesi i automjetit Audi A4, nga pakujdesia e godet me pjesën e parë ballore, automjetin BMË me të cilin rast përveç shkakimit të dëmeve materiale në dy veturat e lartcekura, në të njëjtën kohë pëson lëndime trupore edhe drejtuesi i automjetit BMË, respektivisht paditësi, të cilat lëndime ishin mjaftë serioze, dhe me pasoja të cilat në mënyrë të ndryshme manifestohen edhe në këtë kohë. Në procedurën jashtëgjyqësorë me kërkesë ju kanë drejtuar të paditurës, për zhdëmtim të dëmit jo material, e cila pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe provave të saj-komisioni i shkallës së parë ka ofruar shumën prej 451 euro në emër të kompensimit të dëmit material, ndërsa komisioni i shkallës së dytë ka bërë ofertë në shumë prej 531 euro, mirëpo, paditësi oferratat i konsideron si të pa mjaftueshme dhe jo proporcionale me lëndimet dhe frikën e pësuar, dhe humbjen e aftësive të përkohshme për punë dhe jetë të qetë, andaj duke u bazuar në rrethanat e lartcekura i ka propozuar gjykatës që të caktoj seancën e shqyrtimit kryesor, dhe pas administrimit të provave, ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar. Paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, si në vijim; për të gjitha llojet

dhe intenzitetit të dhimbjeve, është kërkuar shuma prej 3.150 euro, për të gjitha llojet dhe itenzitetet e frikës shuma prej 2.600 euro, në emër të shpenzimeve të mjekimit sipas faktuarave të dorëzuara janë 154 euro që d.m.th. në total, për kompensimin e dëmit është kërkuar shuma prej 5.904,40 euro, me kamat prej 8%, aq sa është e paraparë me ligj, dhe shpenzimet procedurale në shumë totale prej 689 euro, të specifikuar si në vijim: 104 euro për përpilimin e padisë, taksën për padi 40 euro, për dy ekspertizat mjekësore 140 euro, si dhe për 3(tre) seanca të mbajtura nga 135 euro, të cilat gjithsej bëjnë 405 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi të dhëne në seancën gjyqësore të datës 20.11.2019, nëpërmes të autorizuarit të saj, ka deklaruar se nuk është kontestuese baza e kërkesëpadiës por kontestuese është lartësia e kërkesëpadiës, pasi që në bazë të dokumentacioneve mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, andaj për arsye të ekonomizimit të procedurës dhe mos shkaktimit të shpenzimeve është e gatshme për arritjen e marrëveshjes, andaj paditësit i është ofertuar shuma prej 800 euro, për të gjitha format e dëmit material dhe jo material.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1004/20 të datës 10.11.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm Penal, me Aktgjykimin P.nr.211/15, të datës 11.01.2017, të pandehurin E..... J....., me banim në Prishtinë, e ka shpallur fajtor, për shkak se ka kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe e ka dënuar me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjastë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej 1(një) viti, nuk kryen ndonjë vepër penale, andaj baza juridike e kërkesapdisë nuk është kontestuese. Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadiës, sipas propozimit të palës paditëse, ka nxjerrë ekspertizë mjekësore nga ekspertët: Dr.N..... M.....-ortoped-traumatolog dhe Dr.M..... H.....-psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional dhe të argumentuar me ç'rast janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi në aksidentin e përmendur e duke sqaruar se paditësi kanë pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje koke, qafe dhe trupi, lëndim të qafës me mekanizëm kamgjiku, marramendje, të cilat lëndime klasifikohen të natyrës së lehtë trupore pa invaliditet të përhershëm trupor, ka përjetuar dhembje të intensitetit tejet të lartë të cilat ishin në kohëzgjatje prej 3min, të intensitetit të lartë ishin në kohëzgjatje prej 4 orëve, të intensitetit të mesëm të cilat ishin në kohëzgjatje prej 6 javë dhe të intensitetit të ulët 12 muaj, shëmtim nuk ka pasur, ndihma e personit të huaj ka qenë e nevojshme për 2 javët e para pas aksidentit, ushqim i përforcuar ka qenë i nevojshme në 2 javët e para, terapi fizikale ka pasur nevojë për dy(2) herë nga 15 ditë, në dy(2) vitet e para. Paditësi ka përjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë për rreth 3 orë, *(të përcjellura me mundim, marramendje, të rrahura të shpejta të zemrës, frymarrje të vështirësuar, dridhje të muskujve dhe ankesa tjera trupore)*, frikës sekondare me intensitet të mesëm ka pasur në periudhën kohore gjer në 8 javë *(të manifestuar me një pengesa të herëpashershme në gjumë, zgjim të here pas*

*hershëm gjatë natës, indisponim si dhe kufizime i pjesshëm në aktivitetet e përgjithshme jetësore, frikë nga invaliditeti i mundshëm, shkallë më e ultë të tolerancës frustrative dhe ankesa te tjera trupore), frikë sekondare me intensitetet të ulët ka pasur në periudhën kohore gjer në 4 muaj(e që është manifestuar gjatë kohës kur ka dalur në komunikacion apo ngjarje që ja rikujtojnë aksidentin). Në fund, gjykata e aprovoj pjesërisht kërkespadinë e paditësit duke e mbështetur vendimin e saj në nenin 136,137,159 paragrafi 1, dhe 140, nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) lidhur me nenin 323 të LPK-së. Për llogaritjen e kamatës ligjore gjykata u bazua në nenin 382 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës vendosi sipas nenit 449 dhe 452 dhe 463 të LPK-së. Gjykata e refuzoj kërkespadinë e paditësit përtej shumave të gjykuara për faktin se shpërblimi i dëmit jo material nuk mund dhe duhet t’i shkojë përshtati synimeve të padrejta.*

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave nga e drejta material, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nuk gjeti as shkelje që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, e as shkeljeve të tjera nga neni 181 paragrafi 1 dhe 182 paragrafi 2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për aprovimin e pjesërishtëm të kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për aprovimin e pjesërishtëm të kërkesëpadisë së paditësit.

Një ashtu, edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, kur me rastin e vendosjes, është zbatuar neni 136, paragrafi 1 i LMD-së, që përcakton se *“kush i shkakton dëm tjetrit është i detyruar t’ia kompensoj”*, dhe gjithashtu edhe neni 137 dhe 140 i LMD-së që përcakton se *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”* dhe në rastin konkret pa mëdyshje është konstatuar fajësia e të sigurvearit të palës së paditësit dhe se paditësi si pasojë e kësaj ka pësuar dëm të natyrës materiale në kuptim të nenit

137 të LMD-së, prandaj, mbi bazën e të gjitha këtyre arsyeve, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se pretendimet ankimore të palës së paditur në raport me mënyrën e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë, rezultojnë të pa bazuara dhe pa argumentuara dhe si të tilla refuzohen.

Ndërkaq, edhe pretendimet ankimore të të paditurës lidhur me lartësinë e shumave të aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për kompensimin e dëmit jo material dhe material si shuma shumë të larta, gjykata e shkallës së dytë i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të pabazuara, sepse gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shumat në bazë të vlerësimeve profesionale të ekspertëve mjekësor në ekspertiza e tyre të cilët kanë konstatuar lëndimet e pësuar nga paditësi janë të natyrës së lehtë trupore. Andaj, për këtë gjykata e shkallës së parë me të drejtë është bazuar në dispozitat e nenit 183 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, por edhe në bazë të nenin 323 të LPK-së, si dhe kriteret dhe masat për caktimin e shpërblimit jo material, e sidomos duke pasur parasysh shkallën e dhimbjeve fizike dhe frikës, për çka edhe Gjykata e Apelit i ka vërtetuar shumat e kompensimit të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183, par. 2 të LMD-së, i cili decidivisht thotë se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përbalimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfakcion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Si rrjedhojë, nga arsyet e cekura si më lartë edhe pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shumat të larta në raport me lëndimet e pësuar nga paditësi janë plotësisht të pabazuara.

Gjithashtu, sa i përket kamatëvonesës, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, ku i është referuar nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe momentit të përcaktimit të rrjedhjes së saj, dhe kjo vendosje pranohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë, ngase është në përputhje edhe me Mendimin Juridik për Kamatën të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 265/20, datës 01.12.2020, gjegjësisht pikën II, V dhe XIV dhe XV të këtij mendimi, ku përcaktohet ligji i aplikueshëm, shkalla e kamatëvonesës dhe periudha e rrjedhjes së saj dhe vendosja nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje me këto pika, ka gjykuar shkallën e kamatëvonesës prej 8% vjetore nga data e ushtrimit të padisë për dëmin material ndërsa për dëmin jo material nga data e nxjerrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, e të cilën vendosje e pranohet edhe gjykata e shkallës së dytë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ka vendosur në mënyrë të duhur sepse i ka arsyetuar shpenzimet e gjykuara për secilin veprim të ndërmarrë në procedurën kontestimore, e të cilat veprime edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kanë qenë të domosdoshme në mënyrë që gjykata të vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Lartësia është në përputhje me tarifën për përfaqësim dhe po ashtu në përputhje me tarifën për taksa gjyqësore dhe ekspertiza. Pala e paditur është obliguar për pagesën e shpenzimeve procedurale bazuar në dispozitën ligjore të nenit 452 paragrafi 1 të LPK së ku parashihet se *“pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*.

Pika II e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1004/20 i datës 10.11.2020, që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit, mbetet e pashqyrtuar bazuar në nenin 194 të LPK-ës, pr arsyje se asnjë palët ndërgjyqëse këtë pjesë të Aktgjykimit nuk e ka atakuar me ankesë.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.991/2021 me datë 21.05.2024**

**Kryetari i Kolegjit,  
Ardian Ajvazi**